

Statistika të karakteristikave të mjeteve rrugore

Viti 2021*

Tiranë, më 14 Tetor 2022: Në botimin “Statistika të karakteristikave të mjeteve rrugore” jepet informacion mbi numrin e mjeteve rrugore që qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, të regjistruar me status “Aktiv” ose “Të çregjistruara përkohësisht” në Regjistrin Kombëtar Shqiptar të mjeteve rrugore.

Në vitin 2021, numri gjithsej i mjeteve rrugore me status "aktiv" dhe “të çregjistruar përkohësisht” rezulton 740.669 mjete, nga 676.811 mjete të regjistruara deri në vitin 2020, duke u rritur me 9,4 %.

Mjete rrugore sipas llojit

Nga mjetet rrugore sipas llojit, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë “Autoveturat” (80,1 %), "Automjetet për transport të përzier " (6,7 %) dhe “Motor” (5,1 %), (Tab.1).

Në vitin 2021, numri i autoveturave për pasagjerë për 1.000 banorë është 212 krahasuar me 190 në vitin 2020 duke u rritur me 11 %.

Tab. 1 Mjetet rrugore sipas llojit, 2020 - 2021

Lloji i mjetit rrugor	2020	2021	2021/2020 %
Gjithsej	676.811	740.669	9,4
Autoveturë	539.497	593.280	10,0
Automjet për transport të përzier	46.844	49.596	5,9
Motor	33.899	37.931	11,9
Kamion	13.819	14.404	4,2
Autobus	7.627	7.867	3,1
Automjet për transport të veçantë	6.860	7.411	8,0
Ciklomotor	6.661	6.436	-3,4
Gjysëm rimorkio	6.361	6.759	6,3
Tërheqës	4.763	5.138	7,9
Automjet për përdorim të veçantë	3.755	3.977	5,9
Makinë bujqësore	1.743	1.673	-4,0
Rimorkio për transport mallrash	1.527	1.659	8,6
Makinë teknologjike	874	819	-6,3
Motokarro	819	808	-1,3
Rimorkio për transport të veçantë	598	681	13,9
Kategori të tjera	1.164	2.230	91,6

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përllogaritje të INSTAT

Numri i autoveturave deri në Dhjetor të vitit 2021, është rritur me 10,0 %, në krahasim me vitin 2020, automjetet për transport të veçantë janë rritur me 8,0 % dhe automjetet për përdorim të veçantë me 5,9 %, në krahasim me vitin 2020.

Mjetet rrugore sipas qarqeve

Numri më i lartë i mjeteve rrugore është regjistruar në qarkun e Tiranës për vitin 2021, duke zënë 35,0 % ndaj mjeteve rrugore gjithsej të regjistruara në vend.

Tab. 2 Mjete rrugore sipas qarqeve, 2021

Qarku	Mjete rrugore	Autovetura	Autobus	Kamion
Shqipëria	740.669	593.280	7.867	14.404
Berat	30.329	21.969	381	776
Dibër	20.093	17.030	294	552
Durrës	98.020	80.241	1.016	1.672
Elbasan	51.042	40.462	605	1.116
Fier	68.984	54.290	655	1.453
Gjirokastrë	16.760	13.213	209	539
Korçë	37.153	29.520	413	942
Kukës	16.898	14.516	178	461
Lezhë	36.672	30.282	372	773
Shkodër	53.538	42.493	537	937
Tiranë	259.089	208.000	2.593	4.212
Vlorë	52.091	41.264	614	971

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Qarku me numrin më të vogël të mjeteve rrugore është qarku Gjirokastrë me 2,2 % ndaj mjeteve rrugore gjithsej.

Mjetet rrugore sipas kambios

Autoveturat me kambio "Manuale" zënë pjesën më të madhe (62,6 %) të autoveturave gjithsej që rezultojnë me status "aktiv" ose "të çregjistruara përkohësisht" deri në vitin 2021.

Tab. 3 Mjete rrugore sipas kambios, 2021

Loji i kambios	Autovetura	Autobus	Kamion
Manuale	371.643	6.497	13.564
Automatike	215.416	1.244	636
Semi-Automatike	5.480	105	105
E papërcaktuar	741	21	99

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Mjetet rrugore sipas vitit të prodhimit

Numri i autovecurave të regjistruara deri në Dhjetor të vitit 2021, me vit prodhimi 2011-2021 është rritur me 32,7 %, grupi 2000-2010 është rritur me 11,3 % ndërsa grupi i autovecurave me vit prodhim para vitit 2000 ka pësuar rënie me 1,2 %.

Tab. 4 Autoveutura të grupuara sipas viteve të prodhimit, 2020-2021

Viti i prodhimit	2020	2021	2021/2020 %
<2000	138.979	137.250	-1,2
2000-2010	353.380	393.477	11,3
2011-2021	47.138	62.553	32,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Në nivel më të detajuar, deri në Dhjetor të vitit 2021, autovecurat me moshë 11-20 vite përbëjnë 54,2 % të numrit gjithsej të autovecurave me status “aktiv” ose “të çrregjistruara përkohësisht”.

Tab. 5 Mjete rrugore të grupuara sipas moshës, 2021

Mosha	Autoveutura	Autobus	Kamion
0-2 vite	3.992	7	41
3-5 vite	11.423	55	170
6-10 vite	34.560	267	285
11-20 vite	321.337	3.299	3.200
> 20 vite	221.968	4.239	10.708

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Mjete rrugore sipas markës

Ndër markat kryesore të autovecurave që qarkullojnë në vend, dominojnë marka “Mercedes Benz” (18,2 %), e ndjekur nga “Volkswagen” (17,5 %) dhe “Daimler Chrysler” (10,9 %).

Tab. 6 Mjete rrugore sipas markës, 2021

Marka	Autovecurë	Marka	Autobus	Marka	Kamion
MERCEDES BENZ	107.913	MERCEDES BENZ	3.447	MERCEDES BENZ	7.411
VOLKSWAGEN	103.905	DAIMLER CHRYSLER	647	MAN	1.482
DAIMLER CHRYSLER	64.658	FORD	445	DAIMLER CHRYSLER	957
FORD	57.888	IVECO FIAT	399	IVECO FIAT	803
OPEL	31.697	MAN	299	IVECO MAGIRUS	664
AUDI	32.303	RENAULT	260	VOLVO	549
FIAT	23.326	SETRA	230	DAIMLER BENZ	507
TOYOTA	26.160	VOLKSWAGEN	219	SCANIA	323
BMW	19.825	IVECO	233	DAF	292
RENAULT	16.347	SCANIA	188	RENAULT	270
TË TJERA	109.258	TË TJERA	1.500	TË TJERA	1.146

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Deri në Dhjetor të vitit 2021, marka "Mercedez Benz" regjistrohet si marka më e përdorur e autoveurave të regjistruara me vit prodhimi para 2000 dhe viteve 2011-2021. Marka "Volkswagen" regjistrohet si marka më e përhapur e autoveurave me vit prodhimi 2000-2010.

Tab. 7 Autoveura sipas markës dhe viteve të prodhimit, 2021

<2000	%	2000-2010	%	2011-2021	%
MERCEDES BENZ	35,3	VOLKSWAGEN	17,8	MERCEDES BENZ	21,3
VOLKSWAGEN	17,5	DAIMLER CHRYSLER	14,9	VOLKSWAGEN	15,5
FORD	7,5	MERCEDES BENZ	11,7	AUDI	8,7
OPEL	5,7	FORD	11,1	FORD	6,5
DAIMLER CHRYSLER	4,4	OPEL	5,7	HYUNDAI	6,3
AUDI	4,0	AUDI	5,4	SKODA	4,9
FIAT	3,8	TOYOTA	5,6	BMW	5,0
RENAULT	3,0	FIAT	4,1	LAND ROVER	4,3
DAIMLER BENZ	2,8	BMW	3,4	TOYOTA	3,3
BMW	2,3	RENAULT	2,9	FIAT	3,1
TË TJERA	13,7	TË TJERA	17,4	TË TJERA	21,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Mjete rrugore sipas lëndës djegëse

Numri më i madh i autoveurave që qarkullojnë në vendin tonë deri në Dhjetor të vitit 2021 përdorin lëndë djegëse "Naftë" duke zënë 73,6 % nga 73,5 % deri në Dhjetor të vitit 2020, ndjekur nga autoveurat që përdorin lëndë djegëse "Benzinë" me 17,3 % ndaj numrit gjithsej të autoveurave nga 18,2 % që ky grup zinte deri në vitin 2020. Numri i autoveurave që përdorin lëndë djegëse "Naftë" në vitin 2021, është rritur me 10,1 %, në krahasim me vitin 2020. Numri i autoveurave që përdorin lëndë djegëse "Benzinë" është rritur me 4,1 %, krahasuar me vitin 2020.

Tab. 8 Autoveura sipas lëndës djegëse, 2020 - 2021

Treguesi	Nr. Autoveura 2020	Nr. Autoveura 2021	2021/2020 %
Naftë	396.790	436.756	10,1
Benzinë	98.380	102.432	4,1
Benzinë + Gaz	43.022	51.776	20,3
Benzinë + Elektrik	552	901	63,2
Elektrik	362	624	72,4
Gaz	219	339	54,8
Naftë + Elektrik	95	246	158,9
Të tjera hybride	77	206	167,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Numri i autobusëve të regjistruar deri në Dhjetor të vitit 2021, që kanë përdorur lëndë djegëse "Naftë" është rritur me 2,8 %, krahasuar me vitin 2020.

Tab. 9 Autobusë sipas lëndës djegëse, 2020 - 2021

Lënda djegëse	Autobus 2020	Autobus 2021	2021/2020 %
Autobusë Gjithsej	7.627	7.867	3,1
Naftë	7.602	7.812	2,8
Benzinë	6	6	0,0
Benzinë + Gaz	8	16	100,0
Naftë + Elektrik	0	22	-
Gaz	11	11	0,0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Autovetura sipas vëllimit të motorik

Numri i autoveturave të regjistruara deri në Dhjetor të vitit 2021 sipas vëllimit motorik >3000 cc është rritur me 10,9 %, numri i autoveturave me vëllim motorik <=2000 cc është rritur me 10,0 % dhe me vëllim motorik 2001-3000 cc është rritur me 9,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 10 Autovetura sipas vëllimit, 2020 - 2021

Vëllimi motorik	2020	2021	2021/2020 %
<=2000	362.547	398.785	10,0
2001-3000	163.248	179.297	9,8
>3000	13.702	15.198	10,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Vëllimi më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse "Naftë" është 1400 cc-1999 cc duke zënë 53,4 % gjithsej me lëndë djegëse naftë.

Vëllimi më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse "Benzinë", është nën 1399 cc duke zënë 61,4 % të autoveturave gjithsej me lëndë djegëse benzinë.

Tab. 11 Autovetura sipas lëndës djegëse dhe vëllimit, 2021

Vëllimi	Autovetura me Naftë	Autovetura me Benzinë
Autovetura Gjithsej	436.756	102.432
<1399cc	29.964	62.915
1400cc-1999cc	233.286	28.710
>2000cc	173.506	10.807

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i këtij publikimi është paraqitja e treguesve mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor në nivel sa më të detajuar si: mjetet rrugore sipas llojit, mjete rrugore sipas qarqeve, mjete rrugore sipas kambios, mjete rrugore sipas markës, mjete rrugore sipas lëndës djegëse, autoveturat sipas vitit të prodhimit dhe autoveturat sipas vëllimit motorik.

Në detajimin e autoveturave sipas lëndës djegëse, në grupin "të tjera hybride" janë përfshirë kategoritë "Benzinë + Gaz + Elektrike", "Benzinë + Elektrik + Hybrid", "Naftë + Gaz", "Naftë + Elektrik + Hybrid".

Përkufizime

Automjete për transport të përzier (ATP) - përfshihen mjetet që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjese, duke përfshirë dhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit.

Automjete për përdorim të veçantë (APV) - mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të vecantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Automjete për transport të veçantë (ATV) - mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të vecanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Kamion - mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

CC- njësia matëse e vëllimit motorik të mjeteve rrugore e shprehur në centimetra në kub.

Autoveturë - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh, në të cilin numri i vendeve të uljes (duke përfshirë edhe shoferin) nuk e kalon numrin 9.

Autobus - mjet motorik i transportit rrugor i destinuar për transport pasagjerësh me numrin e vendeve të uljes (duke përfshirë dhe vendin e shoferit) me më shumë se 9 vende.

Ciklomotor - mjet me motor, me dy, tre ose katër rrota.

Gjysëm rimorkio - mjet motorik i transportit i destinuar për transport pasagjerësh dhe mallrash.

Makinë bujqësore - mjet motorik me rrota ose me zinxhir i destinuar për t'u përdorur në bujqësi e pylltari, për transport të mallrave bujqësore.

Motokarro - mjete me tri rrota, të destinuar për transport malli. Mund të kenë deri në dy ndenjese për njerëzit që merren me transportin, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit.

Tërheqës- Mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove.

Autovetura të pasagjerëve për 1000 banorë- Ky tregues llogaritet në bazë të stokut të automjeteve në 31 dhjetor dhe numrit të popullsisë në 1 janar të vitit pasardhës.